



vvgb



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr. 1443 Regj
Nr. 785 Prot

Tiranë, më 05.05.2022

URDHËR

“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Drejtuar: P.F Big Gold shpk me Nipt L62730402C
Adresa: Fier,Lagjja 16 Prill,Rruga Aulona ,Godina nr.60/93(Tel:0694065549/0693438639)
Per dijeni: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Adresa: Rr. “Myslym Keta”, Tiranë

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendim Nr.610, datë 12.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1443, Datë 06.10.2020 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj debitorit P.F Big Gold shpk me Nipt L62730402C,në lidhje me titullin ekzekutiv “Proces-Verbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr.0040476, datë 21.12.2017.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.3581 Prot, Datë 13.10.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.610, datë 12.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile Me shkresen Nr.764 Prot date 04.05.2022 eshte derguar Urdher per Vendosjen e Sekuestros Konservative ne QKB. Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se ne date 05.05.2022 nepermjet komunikimit me e-mail dhe telefon “Autoriteti Kombetar i Ushqimit”,Drejtoria Rajonale Fier ka kërkuar pushimin e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.610, datë 12.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ,sepse debitori ka likjuar teresisht detyrimin ne date 21.12.2017.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 37. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 26/2019, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.764 Prot date 04.05.2022 mbi aktivetin e pales debitore P.F Big Gold shpk me Nipt L62730402C.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI